 - (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
 - (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
 - (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët, nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*] / Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[**Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit**]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6 .

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Ftohësi nr 1.

Ky ftohës ndodhet në taracën e godinës së Kirurgjisë dhe është i përbërë nga 4 kompresorë, ku secili prej tyre ka nga dy kondicionerë. Ky ftohës është CLIMA VENETA MODEL WRAT/HT 1222, prodhuar në vitin 2001 dhe përdor gaz R22. Për këtë ftohës kërkohet furnizimi dhe vendosja i njërit prej kompresorëve bashkë me panelin elektronik e elektrik të komandimit. Për kompresorin e dytë kërkohet gjetja e defektit që sjell ndalimin e punës së tij. Në ekran nxjerr error e 901 "Fan thermal cut-outs circuit 1". Kërkohet riparimi i defektit, mbushja me gaz (R 22) dhe vendosja në punë. Për kompresorin e tretë dhe të katërt kërkohet gjetja e defektit, riparimi i defektit, mbushja me gaz (R 22) dhe vendosja në punë. Gjithashtu për këtë ftohës kërkohet riparimi i linjës së shpërndarjes së ujit dhe termoizolimi i tij. Vetëm njeri nga kompresorët e këtij ftohësi është në gjendje pune.

Ftohësi nr. 2.

Ky ftoheë ndodhet në taracën e godinës 4 – katëshe. Ai përbëhet nga 1 kompresor. Ky ftohës është AERMEC model AN3007HA**** Vers.3 me nr serial 0904006590290001. Kërkohet të

bëhet kontrolli i funksionimit të këtij ftohësi, riparimi i tij dhe mbushja me gaz (R 407C). Gjithashtu për këtë ftohës kërkohet riparimi i linjës së shpërndarjes së ujit dhe termoizolimi i tij. Ky ftohës është në gjëndje pune.

Ftohësi nr. 3.

Ky ftohës ndodhet pas godinës së Pediatriisë. Ai përbëhet nga 4 kompresorë. Ky ftohës është model CLINT CHA/K 1208-P PS/FE/NG. Kërkohet të bëhet kontrolli i funksionimit të tij, riparimi dhe mbajtja në gjëndje pune. Ky ftohës është në gjëndje pune.

Ftohësi Nr. 4

VRF në një pjesë të godinës së Pediatriisë. Është në gjëndje pune por herë pas here kërkon restart pasi ndalon. Kërkohet të bëhet një kontroll dhe riparim i mundshëm.

Specifikimi i Materialeve:

- Materialet duhen me certifikate CE.
- Materiale si filtra vaji, rripa, vaj për kompresorët të jenë cilësorë dhe sipas markës së kompresorit/ose ekuivalent.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Pastrimi i njësisë qendrore të ftohësit me solucion dhe ajër me presion (kompresor). Pastrimi i rrugëve të brendshme të ajrit me ajër me presion dhe vakum. Larje me solucion dhe presion ajri (kompresor) i filtrave të ftohësit që nga njësia qendrore e deri në dhomat përkatëse.
2. Testi i provës dhe vendosja në punë ku përfshihet: Kontrolli i presionit të gazit, eliminimi i rrjedhjeve, mbushja me gaz, riparimi i ventilatorëve ftohës, kontrolli dhe riparimi i panelit elektrik, automatikës dhe mbrojtja e tyre.
3. Testi i provës dhe vendosja në punë ku përfshihet: Kontrolli i presionit të gazit, eliminimi i rrjedhjeve, mbushja me gaz (R407C), riparimi i ventilatoreve ftohës, kontrolli dhe riparimi i panelit elektrik, automatikës dhe mbrojtja e tyre.
4. Testi i provës dhe vendosja në punë ku përfshihet: Kontrolli i presionit të gazit, eliminimi i rrjedhjeve, mbushja me gaz (R410A), riparimi i ventilatoreve ftohës, kontrolli dhe riparimi i panelit elektrik, automatikës dhe mbrojtja e tyre.
5. Pastrim i njësisë qendrore të ftohësit me solucion dhe ajër me presion (kompresor). Pastrimi i rrugëve të brendshme të ajrit, me ajër me presion dhe vakum. Larje me solucion dhe presion ajri (kompresor) i filtrave të ftohësit, që nga njësia qendrore e deri në dhomat përkatëse. shërbim
6. Kontrolli teknik për funksionimin dhe mbajtjen në gjëndje pune të VRF (sistem ngrohje dhe ftohje me koka murale).
7. Pastrim dhe larje me presion ajri i filtrave të kondicionerëve në repartin e grafisë, rezonancës, skanerit dhe kondicionerëve mural. Për këtë OE duhet të disponojë kompresor ajri.

-
8. Pastrim dhe larje me solucion, ujë dhe ajër me presion, mbushje me gaz dhe shërbime teknike për frigoriferët e Bankës së Gjakut (R404 A; 0.6kg), kirurgjisë (sallat e operacionit dhe urgjencës), maternitetit (R134A) dhe farmcacisë.
- Shpërndarja e shërbimeve do të bëhet sipas nevojave të AK-së, gjatë ekzekutimit të kontratës. Nuk mund të përcaktohet një periudhë fikse për këto shërbime pasi janë të paparashikueshme së kur lind nevoja.
 - Koha e përgjigjes së OE-së do të jetë brenda 5 ditëve nga Njoftimi i AK.
 - Për zërat të cilat kanë më shumë se një sasi shërbimi, frekuenca e tyre është në baze të kërkesës së AK-së dhe studimit të nevojave.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Nr	Përshkrimi i shërbimeve	Njësia	Sasia	Afati i ekzekutimit
	SISTEMI I KONDICIONIMIT TË KIRURGJISË; TIPI CLIMAVENETA MODEL WRAT/HT 1222			Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
1	F.V. kompresor + paneli elektronik e elektrik i komandimit.	Cope	1	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
2	Riparimi, mbushja me gaz dhe vendosja në punë e kompresorëve me defekt error e901 “Fan thermal cut-outs circuit 1”.	Cope	3	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
3	F.V. Amortizues Presioni Uji i fllanxhuar në tubat e sistemit të qarkullimit të ujit, për ngrohje – ftohje. Diametri = 60 mm dhe gjatesi = 17 cm.	Cope	2	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
4	Pastrim i njësisë qendrore të ftohësit me solucion dhe ajer me presion (kompresor). Pastrimi i rrugëve të brendshme të ajrit me ajër me presion dhe vakum. Larje me solucion dhe presion ajri (kompresor) i filtrave të ftohësit që nga njësia qendrore e deri në dhomat përkatëse.	shërbim	1	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
5	Testi i provës dhe vendosja në punë ku përfshihet: Kontrolli i presionit të gazit; Eliminimi i rrjedhjeve; Mbushja me gaz; Riparimi i ventilatorëve ftohës; Kontrolli dhe riparimi i panelit elektrik, automatikës dhe mbrojtja e tyre.	shërbim	1	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
6	F.V. Kushineta helikash	Cope	12	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
7	F.V. Helika	Cope	2	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
8	F.V. Filter ajri për sallat e operimit me rrjetë metali	copë	10	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
	SISTEMI I KONDICIONIMIT TË GODINËS KATËR KATËSHE ; TIPI AERMEC AN3007HA*** VERS.3			Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër

1	Pastrim i njësisë qendrore të ftohësit me solucion dhe ajër me presion (kompresor). Pastrimi i rrugëve të brendshme të ajrit me ajër me presion dhe vakum. Larje me solucion dhe presion ajri (kompresor) i filtrave të ftohësit që nga njësia qendrore e deri në dhomat përkatëse.	shërbim	1	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
2	Testi i provës dhe vendosja në punë ku përfshihet: Kontrolli i presionit të gazit; Eleminimi i rrjedhjeve; Mbushja me gaz (R407C); Riparimi i ventilatorëve ftohës; Kontrolli dhe riparimi i panelit elektrik, automatikës dhe mbrojtja e tyre.	shërbim	1	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
3	F.V. kushineta të helikave	copë	12	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
4	F.V. Helike	copë	1	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
5	F.V. Lëshues 180 A	copë	1	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
	SISTEMI I KONDICIONIMIT TË GODINËS SË PEDIATRISË ; TIPI CLINT CHA/K 1208-P PS/FE/NG			Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
1	Testi i provës dhe vendosja në punë ku përfshihet: Kontrolli i presionit të gazit; Eleminimi i rrjedhjeve; Mbushja me gaz R410A ; Riparimi i ventilatorëve ftohës; Kontrolli dhe riparimi i panelit elektrik, automatikës dhe mbrojtja e tyre.	shërbim	1	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
2	Pastrim i njësisë qendrore të ftohësit me solucion dhe ajër me presion (kompresor). Pastrimi i rrugëve të brendshme të ajrit me ajër me presion dhe vakum. Larje me solucion dhe presion ajri (kompresor) i filtrave të ftohësit që nga njësia qendrore e deri në dhomat përkatëse.	shërbim	1	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
3	Kontrolli teknik për funksionimin dhe mbajtjen në gjëndje pune të VRF (sistem ngrohje dhe ftohje me koka murale).	shërbim	1	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
4	Presostat i presionit IM1 9002964 30 / 19 (përkohësisht lidhur në urë)	copë	1	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
	SHËRBIME PËR KONDICIONERËT MURAL DHE FRIGORIFERËT E SRD			Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
1	Pastrim dhe larje me presion ajri i filtrave të kondicionerëve në repartin e grafisë, rezonancës, skanerit dhe kondicionerëve mural. (Për këtë OE duhet të disponojë kompresor ajri)	shërbim	35	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër

2	Pastrim dhe larje me solucion, ujë dhe ajër me presion, mbushje me gaz dhe shërbime teknike për frigoriferët e Bankes së Gjakut (R404 A; 0.6 kg), Kirurgjisë (sallat e operacionit dhe urgjencës), Maternitetit (R134a) dhe Farmacisë.	shërbim	7	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
	Materiale dhe shërbime per kaldajat e SRD			Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
1	FV. Filter djegësi kaldaje	copë	16	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
2	F.V. Kokë bek 3,5°	copë	2	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
3	FV. Kokë bek 5,0°	copë	2	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
4	FV. Kokë bek 3,5°	copë	3	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
5	FV. Kokë bek 6,0°	copë	3	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
6	FV. Kokë bek 2,5°	copë	2	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
7	FV. Kokë bek 4,5°	copë	2	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
8	FV. Kokë bek 1,0°	copë	2	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
9	FV. Kokë bek 1,2°	copë	2	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
10	FV. Tub flesibël 1.2 m me diametër 3,8’’	copë	1	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
11	FV. Saraçineskë 1 e ½ “ për kaldajat hyrje daljet në djegës (bruciatore).	copë	10	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
12	FV. Radiatorë me nga 10 elementë + reduksionet	copë	20	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
13	FV Gomine 3/8 “ për radiatorët e ngrohjes	copë	30	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
14	FV. Tub me diametër 63 mm dhe gjatësi 15 m linear me material monozmon. Saldimi i ketij tubi	metër	15	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër

	në segmente të ndryshme sipas nevojës ku ka amortizim ose ndryshkje.			
15	Valvul shkarkimi ajri	copë	6	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
16	F.V. Filtër nafte me gotë	copë	2	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
17	F.V. Servomotor	copë	1	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
18	Saraçineskë 2’’	copë	4	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
19	F.V. Depo xingato 5000 liter	copë	1	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
20	Zmontim dhe montim tubi i shkarkimit të tymrave të kaldajës nga njëra godinë në tjetrën.	m	20	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
	Materiale për kompresorët e ajrit dhe vakumit			Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
1	F.V. Vaj Kompresori	copë	20	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
2	Rripa kompresorësh	copë	6	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
3	Presostat me mbrojtje	copë	1	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
4	Filtra linje	copë	6	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
5	Filtër pompe vakumi	copë	1	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
6	Grupe 7 Hp / 5.5 Kw	copë	2	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
	Mirëmbajtje frigoriferëve të SRD			Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
1	Mbushje me gaz dhe riparim frigoriferi	copë	10	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër

2	Mbushje me gaz dhe riparim dhome frigoriferike	copë	7	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
	Mirëmbajtje kondicionerë mural			Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
1	Mbushje me gaz dhe riparim kondicioneri mural 9 btu – 12 btu	copë	20	Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër

Afatet e ekzekutimit: Sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, specifikimeve teknike dhe termave të referencës, brenda afatit të vlefshmërisë së Marrëveshjes Kuadër

Shtojca 8.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Riparimi, mirëmbajtja e sistemit të ngrohje - ftohjes të Spitalit Rajonal Durrës.

Detyrat:

Operatori duhet të kryejë kontrole të përgjithshme për pastrimin, kolaudimin, mirëmbajtjen profilaktike sipas zërave të parashikuar, me qëllim funksionimin e sistemit në përputhje me kushtet e sigurisë dhe parametrat teknikë të përcaktuara nga prodhuesi.

a) Operatori duhet të hartojë grafikun e shërbimeve të planifikuara të mirëmbajtjes profilaktike dhe t'i vë në dispozicion Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme Çështjeve Juridike dhe Emergjencave.

b) Operatori duhet të mbajë librin e shërbimeve periodike të kryera, ku të pasqyrohen shërbimet e kryera, pjesët e zëvendësuara ose të riparuar, data, ora dhe emrat e punonjësve të shërbimit. Ky liber i vëhet në dispozicion Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme Çështjeve Juridike dhe Emergjencave.

c) Riparimet e tjera janë të parashikuara, por do të kryhen vetëm në rast defekti, me kërkesën e Autoritetit Kontraktor. Në çdo rast do të lidhen kontrata bazuar në Marrëveshjen Kuadër.

d) Operatori Ekonomik është i detyruar t'i përgjigjet menjëherë kërkesës së Autoritetit Kontraktor, duke siguruar riparin e defektit në kohë dhe me cilësi.

e) Operatori Ekonomik është i detyruar të kryejë kontroll sa herë të jetë e nevojshme për konstatimin e defektit të shfaqur. Ky shërbim do të jetë pa pagesë dhe do të ofrohet nga Operatori Ekonomik në funksion të shërbimit të mirëmbajtjes së përgjithshme.

Shpërndarja: Sipas specifikimeve teknike

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: **Në Spitalin Rajonal Durrës, në sistemin e kondicionimit sipas specifikimeve teknike**

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të marrëveshjes kuadër.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

-
- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
 - b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licensë profesionale të vleshme, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategorinë:

NS12-A “Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit”

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar stafin teknik, për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, sipas profileve të mëposhtme:

- a) 1 (një) Drejtues Teknik inxhinier mekanik, i përfshirë në licencën profesionale të ofertuesit
- b) 1 (një) punonjës elektrikist
- c) 1 (një) punonjës mekanik/hidraulik
- d) 1 (një) punonjës të certifikuar për sisteme ngrohje/ftohje

Për punonjësin në pikën a, duhet të paraqitet:

- Diplomë përkatëse
- kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër

Për punonjësin në pikën b, c dhe d duhet të paraqitet:

- kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
- dëshmi aftësie profesionale (të vlefshme), sipas Ligjit Nr.15/2017, “Mbi arsimin dhe formimin profesional”, i ndryshuar

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se Pajisjet/agregatët/materialet që do të përdoren për riparimin e difekteve të sistemeve dhe pajisjeve ngrohëse-ftohëse do të jenë të reja, sipas afateve të garancisë të dhëna nga prodhuesi ose nga distributorë të autorizuar nga prodhuesi.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se është i pajisur me certifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë:

S SH EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

S SH EN ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et	

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarimenëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
